

Arbër Salihu

Reforma agrare në Mbretërinë SKS

dhe ndikimi i saj në pjesët e ndryshme të
vendit





Pyetja kyçe:

Si u zbatua reforma agrare, cilat ishin pasojat në jetën e njerëzve të rëndomtë në pjesët e ndryshme të Mbretërisë së SHS?



Qëllimet

- Kuptimi kritik i natyrës komplekse të së kaluarës
- Kuptimi i problemit të reformës agrare
- Kuptimi shkaqeve dhe pasojave të reformës agrare
- Zhvillimi i vetëdijes historike



Rezultatet e mësimit:

- Nxënësit do t'i njohin arsyet e zbatimit të reformës agrare
- Krahasimi i realizimit të reformës në pjesët e ndryshme të Jugosllavisë
- Analizimi i rolit të reformës në jetën e njerëzve (Si ka ndikuar reforma në jetën e njerëzve?)
- Vlerësimi i efikasitetit të reformës në kuptim të përgjithshëm

Udhëzime për mësuesin

Hapi 1

Hyrje

Hapi 2

Punë grupore

Mësuesin ndan nxënësit në tre grupe:

Grupi 1: Do ta paraqesë pozicionin e Mbretërisë së SHS;

Grupi 2: Do ta vlerësojë zhvillimin e vërtetë të reformës agrare;

Grupi 3: Do ta paraqesë perspektivën si është manifestuar reforma agrare në jetën e njerëzve të rëndomtë. Mësuesin ndan burimet për çdo grup. Ai/Ajo u jep nxënësve udhëzime të nevojshme për punën dhe pyetjet.

Hapi 3

Çdo grup punon duke i analizuar burimet e veta. Grupet pastaj tentojnë t'u përgjigjen pyetjeve për grupin e tyre. Pas analizës së burimeve Grupet i përgatisin përfundimet e tyre.

Hapi 4

Çdo grup i paraqet rezultatet e veta para klasës. Pas kësaj vijon diskutimi.

Hapi 5

Mësuesin jep tre pyetje për debat të hapur. Pyetje janë:

A e ka arritur reforma qëllimin për të cilin është shpallur?

A kanë qenë të kënaqur qytetarët me reformën?

Cilat kanë qenë efektet e reformës?

Hapi 6

Në fund mësuesin e bën tabelën me dy kolona, njërin me efektet pozitive të reformës, dhe tjetrën me efektet negative të reformës. Nxënësit në grupe vendosin cilat tre çështje do t'i theksojnë në çdo kolonë, ndërsa mësuesin i grupit i shkruan në tabelë. Këto përfundime do të jenë temë e diskutimit të ardhshëm mes grupeve.



90
minuta

Reforma agrare në Mbretërinë e SHS	
Efektet pozitive	Efektet negative
1	1
1	1
1	1
2	2
2	2
2	2
3	3
3	3
3	3

Tema

Reforma agrare është çështje shumë e rëndësishme për regjionin, sepse flet për pronësinë mbi tokën dhe ekzistencën e popullsisë. Me këtë punëtori do të përpiqemi t'i paraqesim arsyet e reformës agrare dhe zbatimin e saj në Mbretërinë SKS, si ka përfunduar dhe cilat kanë qenë efektet e saja për jetën e njerëzve në pjesët e ndryshme të vendit.

Burimi 1

Mbretëria S.K.S – vend bujqësor

Mbretëria e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve ka qenë vend tipik bujqësor. Bujqësia ka qenë dega themelore e ekonomisë në të gjitha pjesët e vendit. Njëra nga çështjet më të rëndësishme në Mbretërinë e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve ka qenë çështja e tokës. Strukturat e ndryshme dhe të posaçme të pronësisë mbi tokën në pjesët e ndryshme të vendit, pastaj qëndrimi revolucionar mes fshatarëve në fshatra, kanë qenë arsyet të cilat e kanë arsyetuar marrjen e hapave në organizimin dhe zbatimin e reformës demokratike të tokës në Mbretërinë S.K.S.


G. Drakić, *Agrarna reforma u Kraljevini Srba, Hrvata i Slovenaca - Pojam i osnovne karakteristike*, Free Law Journal, Vol. 3, No. 4, 18 October 2007.

<http://www.freeworldpublishing.com/ILYV12008.pdf> (downloaded April 19, 2013)

Burimi 2

Struktura e profesioneve në Mbretërinë e S.K.S.

- Bujqësia, pylltaria, peshkimi
- Industria dhe zejet
- Tregtia, bankat, qarkullimi
- Shërbimet publike, veprimtari të lira, ushtria
- Profesione të tjera



Zanimanja stanovništva Kraljevine, prema Lj. Dimic, *Kulturna politika Kraljevine Jugoslavije 1918-1941*, str. 35


Burimi 3

Personat e punësuar sipas veprimtarisë kryesore në vitin 1931

Republika	Bujqësia, pylltaria, peshkimi	Industria dhe zejet	Tregtia dhe kreditë	Shërbimet publike, profesionet e lira dhe ushtria	Të tjera	Gjithsejtë
Sllovenia	60,8	21,1	5,7	4,9	7,7	100%
Kroacia	76,3	10,7	4,3	4,2	4,5	100%
Serbia: Serbia qendrore Vojvodina dhe Kosova	79,3	8,9	3,4	4,5	3,9	100%
	62,0	15,2	5,7	5,2	4,7	100%
	85,8	4,9	2,2	3,9	3,2	100%
Bosnja	84,1	6,7	3,1	3,8	2,5	100%
Mali i Zi	78,1	5,8	3,0	8,3	4,8	100%
Maqedonia	75,1	9,4	4,1	7,0	4,4	100%
Sanxhaku	89,3	3,9	1,0	2,5	2,4	100%

Burimi 4

Struktura agrare e Jugosllavisë



M. Mirkovi ,: *Ekonomika historija Jugosllavisë*.
Zagreb: Informator - Zagreb 1968. str. 322.

Burimi 5

Pse është propozuar reforma agrare?

Në Serbi dhe Mal të Zi, situata në fshat ka qenë ndryshe. Fshatarësia ka qenë e preokupuar me çështje nacionale dhe të partive dhe ka luftuar kundër përfituesve të luftës, duke kërkuar t'u ndahet tokë, duke e mbështetur kërkesën e tillë në vendimin e qeverisë serbe të vitit 1917, sipas së cilës "çdo person i cili vullnetarisht i bashkëngjitet ushtrisë serbe dhe merr pjesë në betejat e ardhshme, pas luftës në atdheun e çliruar, në shenjë mirënjohjeje për këtë kontribut, do të fitojë sasi të mjaftueshme të tokës së punueshme e cila mundëson vendosje". Në rrethanat e tilla shoqërore, përfaqësuesit më të lartë të pushtetit në Mbretërinë e S.K.S. vendosën të ndërmarrin masa përkatës që t'i qetësojnë fshatarët. Që t'i përfitojnë fshatarët për ndryshimin e qetë të strukturës ekzistuese pronësore mbi tokën, është formuar Përfaqësia e Përkohshme Nacionale që t'i përgatisë ndryshimet në strukturën pronësore, në përputhje me ligjin.

R. Ljubojevi , Land Property Relations in Yugoslavia During the Dictatorship of King Aleksandar.,
Original scientific paper UDC 32.2.021.8
(497.1)"1918/1941"

<http://www.megatrendreview.com/files/articles/015/18.pdf> (downloaded April 19, 2013)

Pyetje:

1. Pse qeveria ka qenë e interesuar për zbatimin e reformës agrare?
2. Cilat masa i ka ndërmarrë qeveria për zbatimin e reformës?

Burimi 2

Komisioni për përgatitjen e rregullave për reformën agrare

Proklamata e Mbretit Aleksandër e 21 dhjetorit 1918 e thekson nevojën e reformës agrare. Në bazë të proklamatës është formuar Komisioni për përgatitjen e rregullave për zbatimin e reformës agrare. Komisioni i ka pasur anëtarët vijues të përhershëm: Vitomir Koraç, ministër i punëve sociale, dr. Zhivko Petriçiq, ministër i bujqësisë dhe dr. Urosh Krulj, ministër i shëndetësisë. Dr. Mehmed Spaho, ministër i pylltarisë dhe xehetarisë, ka qenë i emëruar si anëtar i përkohshëm. Detyra e ndërlikuar para Komisionit është shprehur në çështjen sepse reforma agrare ka pasur karakter politik, shoqëror dhe ekonomik. Karakteri politik është pasqyruar në uljen e tensioneve shoqërore.

R. Ljubojevi , *Land Property Relations in Yugoslavia During the Dictatorship of King Aleksandar*, Original scientific paper UDC 332.2.021.8 (497.1)"1918/1941" <http://www.megatrendreview.com/files/articles/015/18.pdf> (downloaded April 19, 2013)

Burimi 4

Normat paraprake për përgatitjen e Reformës Agrare të 27 shkurtit 1919

I. Pezullimi i raporteve të çifçinjve

1. Raportet e çifçinjve në Bosnje dhe Hercegovinë, dhe në hapësirat e reja të Serbisë dhe Malit të Zi pezullohen, ndërsa krijimi i marrëdhënieve të reja të çifçinjve ndalohen.
2. Çifçinjtë e gjertanishëm shpallen pronarë të lirë të tokave të gjertanishme të çifçinjve.
3. Pronarët e gjertanishëm (agallarët) fitojnë dëmshpërblim për tokën e marrë, të cilën ua garanton shteti. Me ligj të posaçëm do të përcaktohet lartësia e dëmshpërblimit dhe mënyra se si do të paguhet.
4. Në dëmshpërblim do të llogariten edhe borxhet e çifçinjve për vitin 1918.

II. Pezullimi i raporteve kolonizuese

7. Raportet e kolonizimit dhe të ngjashme të çifçinjve mes pronarëve të tokës fermerëve në Istrë, Goričkë, Dalmaci dhe zonat tjera të Mbretërisë së Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve pezullohen në pajtim me institucionet e kreut të parë të këtyre normave.

Služ

Burimi 3

Çka është proklamuar për reformën agrare?

Është thënë se reforma ka qenë "masë revolucionare" si proces i kalimit nga feudalizmi në kapitalizëm, të cilin e ka ndërmarrë shteti, me qëllim që të bëjë ndryshime në pronësi mbi tokën bujqësore.

Siç është shprehur, çështja e reformës agrare ka qenë tejet e ndërlikuar që ta zbatojë Ministria e Politikës Sociale. Si rezultat i kësaj ka qenë se qeveria e Mbretërisë S.K.S. e ka braktisur idenë e Zyrës Shtetërore, kështu që më 2 prill 1919 e ka emëruar ministrin e parë të reformës agrare dr. Franjo Polak (1877 – 1939).

R. Ljubojevi , *Land Property Relations in Yugoslavia During the Dictatorship of King Aleksandar*, Original scientific paper UDC 332.2.021.8(497.1)"1918/1941" <http://www.megatrendreview.com/files/articles/015/18.pdf> (downloaded April 19, 2013)

Burimi 1

Raportet agrare në Jugosllavi

Në asnjë vend tjetër në Evropë nuk kishte raportet të shumëllojshme, të ndërlukuara dhe të vështira agrare, siç kishte në krahinat e ndryshme në Jugosllavi, ku është kryer Bashkimi... çdo krahinë kishte raportet e saja të veçanta agrare”.

<http://freeworldpublishing.com/Files/FLJV3N4-Oct2007-2.pdf>
(downloaded April 19, 2013)

Burimi 3

Pronësia e tokës

Mbretëria e Jugosllavisë (në atë kohë e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve) i pezulloi raportet feudale me urdhrin e vitit 1919, ndërsa për shkak të problemeve me pagesën e kompensimit për pronarët e mëparshëm, qeveria miratoi rregullin e vitit 1920 me të cilin pronat e mëdha u vendosën nën mbikëqyrjen e shtetit. Çifçinjët e dikurshëm në Bosnje dhe Hercegovinë, shumica e tyre serbë, fituan tokë falas, ndërsa pronarët e mëparshëm u dëmshpërblyen me para dhe obligacione shtetërore. Në Bosnje dhe Hercegovinë, rreth 113.000 familje pranuan 775.233 hektarë tokë, prej të cilëve 4.000 ishin në pronësi të agallarëve dhe bejlerëve, ndërsa mbi 500.000 hektarë ishin të destinuar për kultivimin e drithit. Në Kosovë, Metohi, në juridiksionin e Rashkës dhe Maqedoni, 20.547 familje të çifçinjve fituan të drejtën e tokës të cilën e punonin.

Deri në fund të vitit 1936 rreth 350.000 hektarë tokë ishte përcaktuar për kolonizim. Në Maqedoni, rreth 500.000 familje vendase dhe të kolonizuara fituan tokë nga 290.000 pronarë turq, dhe ca tokë shtetërore. Në fillim të viteve të 20-ta të shekullit XIX, Mbretëria e Jugosllavisë e filloi reformën agrare dhe e zmadhoi kolonizimin e familjeve të varfra nga Krajina, Lika, Mali i Zi dhe Hercegovina në Vojvodinë, Kosovë dhe një pjesë në Maqedoni. Krahës qëllimit ekonomik, ekzistonte edhe qëllimi politik: mbrojtja e kufirit të pasigurt me Hungarinë dhe Shqipërinë, dhe vendosja e baraspeshës së dëshiruar demografike”.

B., Du an, *Nova istorija srpskog naroda*, Beograd, 2000, str. 287 i 293.

Burimi 2

Reformat agrare dhe kolonizimi

Reformat agrare dhe pezullimi i raporteve feudale, gjysmëfeudale dhe kolonizuese ishin masat më të rëndësishme ekonomike në një vend kryesisht bujqësor. Reforma zbatohej ngadalë dhe pa konsistencë. Maksimumi i tokës, i cili ishte vendosur në fillim, vazhdimisht rritej (nga 57 deri në 288 hektarë). Në numrin më të madh të vendeve reforma u injorua për arsye të ndryshme politike, ose për shkak se asnjëherë nuk është iniciuar (për shembull toka e bejlerëve në Kosovë, Maqedoni dhe Sanxhak është përjashtuar, sepse organizatën politike të mbetur nga administrimi turk e shfrytëzonin që ta kushtëzojnë pranimin e organizimit unitar dhe centralist të Kushtetutës). Qeveria gjithashtu e shfrytëzonte reformën e tokës për ndarjen e lirë të tokës vullnetarëve ushtarakë dhe në atë mënyrë e mbante kolonizimin serb në Vojvodinë, Sllavoni, Maqedoni, Kosovë dhe Metohi, ndërsa i diskriminonte pakicat nacionale. U ndanë 1.7 milionë hektarë tokë, veçanërisht toka të pronarëve të huaj. Zbatimi i reformave haste në obstrukcione të pronarëve të cilët ishin kundër, veçanërisht kisha”.

B. Repe, *Sodobna zgodovina: u benik za 4. letnik gimnazij*, Modrijan, Ljubljana 2007, str. 96

Burimi 4

Kolonët në Kosovë

Numri i kolonëve të cilët arritën në Kosovë ishte mbi 12.000 familje, rreth 70.000 njerëz gjithsejtë, që arrinte mbi 10% e popullsisë së përgjithshme të Kosovës.

O. Milorad, *Agrarna reforma i kolonizacija na Kosovu 1918-1941*, Prishtinë, 1981, str. 221

Burimi 5

Kushtimi i kolonizimit dhe ndryshimit demografik

Për programin e kolonizimit u shpenzua një sasi madhe e parave. Shpenzimet gjatë viteve 1928-1929 vetëm në Kosovën perëndimore arrinin 10 milionë dinarë (përafërsisht 180.000 dollarë amerikanë në atë kohë). Përmasat e këtij operacioni ishin të mëdha në periudhën mes dy luftërave, më tepër se 200.000 hektarë tokë bujqësore u morr nga pronarët e tyre. Anekënd Kosovës kishte vetëm 584.000 hektarë tokë bujqësore, prej saj 400.000 hektarë ishte tokë e lëvrueshme.

Noel Malcom, *Kosova një histori e shkurtër*, Prishtinë, 1998, str.293,

Burimi 6

Territoret e Sekretariatit të Lartë të Reformës Agrare


Legjenda:

Harta e territoreve të
Sekretariatit të Lartë të
Reformës Agrare në
Shkup.

Vështrimi grafik i kolonizimit sipas regjioneve nga fillimi deri në vitin 1941.

I përpiluar në bazë të të dhënave të mbledhura nga kryesitë e rretheve në fund të vitit 1939.

J. Osmani, *Lënda arkivore për kolonizimin dhe reformën agrare në Kosovë 1918-1941*, Prishtinë, 1996.



Burimi 7

Familjet e kolonëve të vendosura në Kosovë

Numri i familjeve të kolonëve të vendosura në Kosovë sipas	
1919 – 1931	1931 – 1941
5975	5588


Obradović Milorad, The agrarian reform and the colonization in Kosovo 1918-1941, Pristina 1981, prema: AJ, 96-21-71 The statistical data of Kosovo colonization according to years;

Burimi 8

Kolonizimi i viseve jugore

Dekretet për Kolonizimin e viseve Jugore, për të cilin folëm paraprakisht sot hyn në fuqi. Për zbatimin e tij Ministrisë së Reformës Agrare i është miratuar kredi prej 20 milionë dinarë. Kështu më në fund çështja e tejzgjatur është hequr nga rendi i ditës. Por krahas gjithë kësaj, interesimi i atyre që dëshironin dhe kërkonin t'i popullojnë këto vise duket se u zvogëluar plotësisht, duke gjykuar sipas numrit të vogël të kërkesave për kolonizim. Gjithashtu as numri i personave tanimë të vendosur nuk ishte aq i madh, mbi të gjitha rreth katërmijekatërqind persona. Deri tani kryesisht kolonët janë shpërndarë në rrafshinën pjellore të Metohisë, pastaj në Kosovë dhe më në fund të rrethinën e Kumanovës dhe të Tetovës. Përpjekja për vendosjen në vendet e kultivimit të vreshtave rreth Tikveshit dhe rrethinës së Bregallnicës nuk pati sukses për shkak të malaries që atje është e shpeshtë dhe e fuqishme. Gjithashtu as zonat e populluara me popullsi me element të pastër shqiptar nuk ishte e mundur që të kolonizohen. Kolonët e gjertanishëm në viset jugore tanimë i kanë themeluar kooperativat e tyre bujqësore, të cilat ishin paraparë me dekretin e mëhershëm. Edhe më tej këtyre kooperativave do t'u ndahet ndihmë në këste dhe nga 100 mijë dinarë por me kusht që kreditë e ndara të shpenzohen për ato qëllime që janë paraparë me dekret. Në rast të kundërt, dhënia e ndihmës do të ndërpritet. E njëjta gjë vlen për kolonët e rinj, të cilët krahas kooperativave bujqësore dhe të Vardarit, duhet të themelojnë dhe bashkësi agrare, të cilave Ministria e Reformës Agrare do tua garantojë pagesën e kredive të shpenzuara.

Gazeta "Politika", Beograd, 20 nëntor 1920



Burimi 1

Rrëfimi i një plake

Rrëfimi i plakës së quajtur Melika Akbad, e cila gjatë intervistës ishte 103 vjeç:

“... Erdha në Turqi kur isha 7 vjeç. Erdhëm me anije në të cilën lindi motra ime. Kur erdhëm te ferma që na u dha shteti turk, kishim frikë se atje do të mendojnë se jemi shkiqe (sllavë-krishterë). Vuajtëm shumë sepse nuk kishim çka të hamë. Nëna na përgatiste gjellë vetëm nga qepa, pa aspak kripë, vaj ose fruta, dhe kështu na ushqente të tre motrave. Në fillim shteti na jepte vetëm një pjatë të vogël me miell misri ose gruri. Disa gra kishin mbetur pa bura, qoftë për shkak se kishin vdekur ose sepse shteti i kishte çuar në detyra të ndryshme. Pas një kohe ishim të detyruar të shpërngulemi dhe tre vite jetuam në xhami...”

<http://www.youtube.com/watch?v=mBfPZgvNxXQ&NR=1&feature=endscreen>
(downloaded November 25, 2012)

Burimi 3

Ankesa e një pronari të tokës

Në ankesën e pronarit të tokës, beut Miralem Begović nga Derventa, e cila në gusht të vitit 1920 i është dërguar Ministrisë së Reformës Agrare, është thënë si në vijim: “Uzërpimi i pronave tokësore ka marrë hov të madh; pronat janë marrë pa urdhëresa, pa ligj, pa autorizim, gjykim dhe vendim, thjeshtë janë marrë me forcë fizike; uzurpatorët me këtë rast u bënë më të pasur se pronarët e tokës”. Për veten personalisht Begović thotë “që është luajal, që e respekton ligjin dhe me durim pret që çështja agrare të rregullohet me ligj”. Edhe ai edhe të partë e tij e kanë punuar tokën. Toka e tij është punuar racionalist (në Ljubljana Dolna, gjithsejtë 1.300 hektarë, prej së cilës 400 hektarë tokë beu). Në tokën e beut kishte edhe çiflig. Begović thotë se “për shkak të lakmisë së banorëve të atjeshëm” e ka humbur jo vetëm çifligun por edhe tokën e beut dhe vendin e mbjellë me kumbulla. Ka mbetur plotësisht pa tokë, edhe pse, siç ka thënë... Pronën e tij të lirë, të cilën fshatarët ia kanë marrë me forcë, ai një pjesë e ka trashëguar nga babai, ndërsa ai nga babai i tij ose gjyshi, si tokë të lirë. Nëse pjesët e tokës së beut ishin nën të drejtat e çifciut, “çifçinjtë e dikurshëm ia kanë dhënë të drejtat e tyre babait tim dhe mua, dhe kanë pranuar para për kundërvlerën e plotë të tokës...”.

N. ehi, Bosna i Hercegovina 1918-1925, Institut za istoriju u Sarajevu, Sarajevo 1991, 55 i 56; Isto, prez. br. 11033/1920.

Burimi 2

Reforma agrare në Kroaci

Njëra nga karakteristikat e ekonomisë kroate, por edhe e tërë Mbretërisë së SKS ishte bujqësia shumë e prapambetur. Shkak ishte copëzimi i madh i pronës bujqësore. Gjegjësisht, në vend kishte rreth 2 milionë prona të imëta të cilat kishin me 5 dhe 10 hektarë dhe në të cilat shfrytëzoheshin vegla shumë primitive – plugje të drunjt, si në mesjetë. Shteti në vitin 1919 i solli normat për zbatimin e reformës agrare me të cilat ishte e paraparë marrja e pjesës së pronave të mëdha dhe ndarja e tyre fshatarëve të varfër. Në Kroacinë Veriore u ndanë rreth 107.000 ha tokë nga pronarët e mëdhenj rreth 100.000 personave të interesuar, por edhe kjo masë pozitive kishte anë negative sepse toka iu ndahej përkrahësve politikë. Ishte koha e ndryshimit të përbërjes nacionale të viseve joserbe. Gjegjësisht, regjimi i Beogradit përkrahësit e tij më të zjarrtë i vendoste në hapësirat e pasura joserbe. Kjo kishte posaçërisht të bënte me të ashtuquajturit “selanikas”, luftëtarë nga Lufta e Parë Botërore, të cilët në Kroaci fituan falas tokë, ndërsa të interesuarit e tjerë duhej të paguajnë. Reforma agrare deri diku e ndryshoi strukturën e pronësisë në Kroaci, por mbetën ende prona të mëdha dhe fshatarë pa tokë.

M. Kolar Dimitrijevi, H. Petri, J. Ragu, Povijest IV (Ud benik iz povjest za 4. razred gimnazije), Meridijan, Samobor 2004, str. 82

Burimi 4

Kushtet e banimit të kolonëve

Kolonizimi mori formë të caktuar me Urdhëresën për Kolonizim të të ashtuquajturave “vise jugore” të 24 shtatorit 1929. Me atë urdhëresë u caktuan tokat për kolonizim: 1. Toka të lira shtetërore, 2. Toka komunale dhe të fshatit, 3. Toka të shkreta dhe toka që i kanë lëshuar fshatarët. Gjatë vendosjes kolonët kishin të drejtë për transport falas të të gjithë anëtarëve të familjes, bagëtisë dhe orendive shtëpiake. Kolonët kishin të drejtë për shfrytëzim falas të pyjeve komunale për ndërtimin e shtëpive, kullotave falas nëpër kullotat e fshatit dhe komunale. Kolonët ishin të liruar nga pagesa e tatimit ndaj shtetit, rretheve, provincave dhe komunave në kohëzgjatje prej 3 viteve.

1918-1941,

2002, ctp. 288-289

Burimi 5

Reforma agrare në Bosnje dhe Hercegovinë

Procesi i zgjidhjes së çështjes agrare në Bosnjë filloi në vitin 1919, e cila i dëmtoi më shumë pronarët myslimanë të tokave. Vitin e njëjtë, përafërsisht 400.072 hektarë u morën nga pronarët myslimanë. Normat ligjore për implementimin e reformës agrare shkaktuan një dhunë të madhe ndaj myslimanëve. Pronat e tyre u grabitën dhe u dogjën, prona u mor dhe shumë familje migruan në Turqi. Gjatë këtyre grabitjeve qindra myslimanë u vranë në Bosnjë Lindore, Hercegovinë Lindore dhe në Malin e Zi (Sanxhak).

Burimi 6

Familje nga Obrovaci e kolonizuar në Vojvodinë gjatë kohës së Mbretërisë së SKS



Burimi 7

Të dhëna krahasuese për tokën e eksproprijuar nga reforma agrare në Jugosllavinë monarkiste

Regjioni	Sipërfaqja në hektarë	Përqindja e përgjithshme	Numri i familjeve që kanë pranuar tokë	Sipërfaqja mesatare e tokës së fituar në ha
B dhe H	1.286.227	66,9%	249.580	4,71
Maqedonia, Kosova dhe Sanxhaku	231.099	12%	48.261	4,79
Dalmacia	50.000	2,6%	96.953	1,94
Sllavonia	110.577	5,7%	99.908	1,11
Vojvodina	222.707	11,8%	100.004	223
Slllovenia	23.697	1,2%	19.987	1,19

E. Mutap i , Pravno-historijski kontekst agrarne reforme u BiH poslije Prvog svjetskog rata, <http://hrcak.srce.hr/74666> (downloaded November 25, 2012) sve skupa izvan okvira